



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë më, 05.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 31 tetor 2018.
2. Miratimi i kalendarit të veçantë të komisionit për shqyrtimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019".

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Nuri Belba dhe Vilma Bello (*Deputete zëvendësuese*).

Mungojnë:

Petrit Vasili, Klodiana Spahiu, Bardh Spahia, Vangjel Tavo, Floida Kërpaçi, Grida Shqina, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj dhe Halim Kosova.

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Mirëdita të gjithëve!

Sot jemi mbledhur për miratimin e kalendarit të veçantë të komisionit, shqyrtimi i projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019". Në fakt, kemi një kalendar të ngjeshur, sepse kemi dy data të detyrueshme, në datën 16 nëntor duhet të dërgojmë te Komisioni i Ekonomisë dhe Financës raportin për projektligjin në parim dhe në datën 23 nëntor raportin për projektligjin nen për nen. Për ta bërë të mundur këtë gjë, kemi menduar që nesër, datë 6 nëntor, në orën 09:30, përpara seancës së posaçme, të bëjmë shqyrtimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë". Nuk besoj se mbledhja do të zgjasë më shumë se gjysmë ore, kështu që do të takohemi në orën 09:30 te salla e parlamentit.

Të mërkurën, datë 7 nëntor, ora 10:00, do të bëjmë shqyrtimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019" me ministren e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale po këtu në këtë sallë dhe besoj se të gjithë jeni dakord.

Shpresojmë që informacioni të na vijë paraprakisht që nesër që të kemi një ditë përpara, kështu që, ju lutem, kujtojuani pak përfaqësuesve të ministrisë të na dërgojnë informacionin.

Të hënën, datë 12 nëntor, ora 11:00, do të bëjmë shqyrtimin po në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019" me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe po shqyrtimin në parim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në datën 14 nëntor, ora 11:00, do të bëjmë një seancë dëgjimore publike me grupet e interesit "Për buxhetin e vitit 2019". Duke qenë se në komisionin tonë ka shumë grupe interesi, të cilat vijnë dhe interesohen, u kemi dërguar paraprakisht një kërkesë për opinion në lidhje me buxhetin dhe po presim *feedback*-un e tyre dhe më pas ato shoqata, grupe apo individë që do të kthejnë përgjigje do të ftohen në seancën dëgjimore të posaçme, siç jua thashë në datën 14 nëntor.

Do të bëhet dorëzimi i raportit për projektbuxhetin në parim dhe më pas do të vijojmë të enjten, datë 22 nëntor, me shqyrtimin në parim në seancë plenare të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019" dhe i projektligjeve financiare që lidhen me këtë buxhet.

Të mërkurën, datë 21 nëntor, ora 11:00, do të bëjmë shqyrtimin dhe votimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019". Ju kërkoj ndjesë, pasi në datat 18-20 nuk do të jem e pranishme dhe për këtë arsye mbledhjen e kemi lënë në datën 21 nëntor, votimin e

buxhetit nen për nen. Brenda datës 23 nëntor duhet të kemi dorëzuar raportin e komisionit tonë te Komisioni i Ekonomisë dhe Financës.

Të hënën, datë 3 dhjetor, shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi në seancë plenare i projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019".

Ky është kalendari deri në datën 3 dhjetor.

A ka sugjerime apo çështje?

Po, zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji – Do të doja të kisha pak vëmendjen dhe t'i bëja një kërkesë edhe sekretarisë së komisionit për pjesën e seancës dëgjimore. Pra, duhet të jemi të vëmendshëm që të mos harrojmë ndonjë individ apo institucion të interesuar, ashtu siç e tha edhe doktori, megjithëse ai mund t'jua thotë vetë, për pjesën e propozuar të rektoratit të universitetit.

Elisa Spiropali – Ju lutem, nëse keni sugjerime, na i nisni që të bëjmë të mundur lajmërimin e institucioneve apo shoqatave që ju i keni në vëmendje! Ne duhet t'i bëjmë sa më të hapura seancat dëgjimore dhe komisioni ynë është shquar për dëgjuesat e hapura me grupet e interesit.

Po, zoti Xhelilaj.

Roland Xhelilaj – Unë nuk kam ndonjë gjë, jam dakord me programin, por kam vetëm problemin e orareve me komisionet, për arsye të përplasjeve. Gjithashtu, sekretaria e komisionit duhet të marrë masa që zëvendësuesit të jenë në gatishmëri për të plotësuar kuorumin.

Elisa Spiropali – Do ta kemi pak të vështirë, sepse edhe sot janë 4 komisione që po zhvillojnë mbledhje. Duke qenë që buxheti është mjaft i ngjeshur mund të kemi disa përplasje, por do të bëjmë më të mirën me zëvendësuesit.

A ka sugjerime për kalendarin? Nuk ka.

Hedhim në votim kalendarin, ashtu siç u lexua? Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Faleminderit dhe shihemi nesër!

MBYLLET MBLEDHJA